



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 2 mars 2015  
Nr. ref.:RK 775/15

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**Rastin nr. KI120/14**

Parashtrues

**Agjencia Kosovare e Privatizimit**

**Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjyimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, II. C. nr. 79/2009, të 27 tetorit 2009, dhe të Aktgjyimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ae. nr. 45/2012, të 20 majit 2013**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

#### Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Agjencia Kosovare e Privatizimit, Zyra Rajonale në Pejë (në tekstin e mëtejme: AKP-ja), e cila përfaqësohet nga z. Gëzim Gjoshi, Zyrtar Ligjor në AKP.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, II. C. nr. 79/2009, të 27 tetorit 2009 dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae. nr. 45/2012, të 20 majit 2013, i cili i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 17 qershor 2013.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, II. C. nr. 79/2009, të 27 tetorit 2009, me të cilin ishte refuzuar padia e parashtruar nga AKP-ja kundër Komunës së Klinës, dhe të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ae. nr. 45/2012, të 20 majit 2013, me të cilin ishte refuzuar ankesa e parashtruar nga AKP-ja, si e pabazuar, dhe ishte vërtetuar Aktgjykimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë.

## **Baza juridike**

4. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 në lidhje me nenin 21.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 22 korrik 2014, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
6. Më 6 gusht 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI120/14 caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 20 gusht 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës së Apelit.
8. Më 17 nëntor 2014, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Prishtinë që të dorëzojë një kopje të fletëkthesës, që tregon datën kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar aktgjykimin e kontestuar.
9. Më 1 dhjetor 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë dorëzoi dokumentin e kërkuar në Gjykatë, i cili dëshmon se parashtruesi i kërkesës e ka pranuar aktgjykimin e kontestuar më 17 qershor 2013.
10. Më 12 shkurt 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

11. Më 6 mars 2009, parashtruesi i kërkesës ka parashtruar padi në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë kundër Komunës së Klinës për kompensimin e dëmeve që janë shkaktuar nga rrënimi i Hotelit "Mirusha", pjesë e Kooperativës Bujqësore "Lavra", e cila si një ndërmarrje shoqërore në përputhje me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 03/L-067 (i miratuar më 21 maj 2008), është nën administrimin e AKP-së.
12. Më 27 tetor 2009, Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë nxori Aktgjykimin II. C. nr. 79/2009, duke refuzuar padinë e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar. Në arsyetimin e këtij aktgjykimi, *inter alia*, thuhet se: *"Për tu sajuar përgjegjësia juridiko-civile e kompensimit të dëmit në bazë të nenit 154 dhe 158 të LMD-ës, duhet detyrimisht të përmbushen këto kritere dhe atë që paditësi pësoi dëm për shkak të veprimit të palejuar dhe kundërligjor të paditurit, dhe i padituri për veprimin e tij të jetë përgjegjës për shkaktimin e dëmit me rrënimin e objektit dhe asgjësimin e gjësendeve, që këto veprime që janë ndërmarrë të jenë në kundërshtim me Ligjin, për dëmin e shkaktuar të jetë fajtor i padituri si dhe të ekziston lidhja e kauzave ndërmjet veprimeve kundërligjore, të paditurit dhe dëmeve të shkaktuara. Duke i vlerësuar provat e nxjerra dhe faktet e vërtetuara Gjykata erdhi në përfundim se të gjitha veprimet juridike për rrënimin e motelit "Mirusha" në Klinë, janë marrë në vështrim të dispozitave të Ligjit për ndërtimet, me që komuna disponon dhe administron me tokën komunale publike urbane, dhe me të gjitha objektet që gjinden në të".*
13. Më 14 janar 2010, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës duke kontestuar Aktgjykimin II. C. nr. 79/, të 27 tetorit 2009, për shkak të *"shkeljes së dispozitave të së drejtës materiale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale"*.
14. Më 20 maj 2013, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin Ae. nr. 45/2012, duke e refuzuar ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar. Në arsyetimin e këtij aktgjykimi, Gjykata e Apelit konstatoi se: *"Gjykata e shkallës së parë e ka zbatuar drejt të drejtën materiale, ngase paditësja as në procedurën e shkallës së parë, e as në procedurën ankimore nuk ka ofruar prova me të cilat do të kishte provuar bazueshmërinë e kërkesëpadisë, sipas dispozitës së nenit 319 të LPK, nëse gjykata në bazë të provave të administruara nuk mund të vërtetoj me siguri ndonjë fakt mbi ekzistimin e fakteve, ajo me zbatimin e rregullave të barrës së provave, në rastin konkret do të konkludojë se barrën e provave për të provuar bazueshmërinë e padisë e ka paditësi, prandaj gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejt kur ka konkluduar se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar"*.

## **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

15. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit është nxjerrë me shkelje të së drejtës së tij të garantuar me Kushtetutë dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ), përkatësisht:

- “ i) *Shkelje të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë të përcaktuar me kapitullin VII, neni 102, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me të cilin përcaktohet se gjykatat gjykojnë në bazë të kushtetutës dhe ligjit;*
  - ii) *Shkelje të nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me të cilën është përcaktuar e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm;*
  - iii) *Shkelje të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, (KEDNJ), neni 6, me të cilën parashihet gjykim i drejtë dhe i paanshëm; dhe*
  - iv) *Shkelje të parimeve të përgjithshme juridike“.*
16. Parashtruesi po ashtu pretendon se me Aktgjykimin e kontestuar, është zbatuar gabimisht e drejta materiale dhe se aktgjykimi përmban shkelje substanciale të dispozitave të procedurës kontestimore.
17. Parashtruesi i kërkesës më tej deklaroi se gjykatat e rregullta nuk e kanë aplikuar ligjin e duhur kur i kanë nxjerrë vendimet e tyre në lidhje me kontestin.

### **Pranueshmëria e kërkesës**

18. Gjykata vëren se në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, së pari duhet të shqyrtohet nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
19. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet Kushtetutës, e cila parasheh:

Neni 113.7

*“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

Dhe neni 21.4

*“Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme”.*

20. Përveç kësaj, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh:

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.*

21. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 36 (1) c) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

*“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*

[...]

c) *kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesi*".

22. Gjykata vëren se vendimi i fundit në procedurë në gjykata të rregullta ishte ai i Gjykatës së Apelit të Kosovës, i nxjerrë më 20 maj 2013 dhe i cili i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 17 qershor 2013, ndërsa parashtruesi e parashtroi kërkesën në Gjykatë më 22 korrik 2014, d.m.th. më shumë se katër muaj nga dita kur parashtruesit të kërkesës i është dorëzuar vendimi i Gjykatës së Apelit.
23. Nga kjo rrjedh se kërkesa është e papranueshme si e paafatshme, në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, më 12 shkurt 2015, njëzëri

### **VENDOS**

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


**Gjyqtari raportues**



Robert Carolan



**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**



Prof. dr. Enver Hasani